



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:041362

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465719

Ac.nr.4261/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. H. nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F. S., avokat në Gj., kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Valdete Rudi, me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar, dhe vlera e kontestit 1,448.61 euro, duke vendosur sipas ankesës së palëve ndërgjyqëse të parashtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.255/2021, të datës 15.04.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pathemelta ankesat e paditëses K. H. nga Gj. dhe e të paditurës, Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.255/2021, i datë 15.04.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.255/21 të datës 15.04.2022, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses K.H. nga Gj., ashtu që ka detyruar të paditurën Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, që paditëses K. H., nga Gj., në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj vlerën e tri pagave bazë, dhe atë në shumën prej 1,131.00 euro me kamatë ligjorë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 03.03.2021 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269,00 euro e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumat e gjuquara, dhe atë që në emër të kompensimit të tri pagave jubilarë t’ia paguaj shumën prej 317,61 euro.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, duke e hudh poshtë aktgjykimin e atakuar me ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur edhe paditësja, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses apo që çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat e palëve ndërgjyqëse janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, K.H. nga Gj., me datë 03.03.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, me objekt kompensimin e shpërblimit jubilar. I autorizuari i paditëses, thekson se paditësja i ka mbi 30 vite përvojë pune tek e paditura, gjë e cila vërtetohet me vërtetimin e marrëdhënies së punës së lëshuar nga e paditura. Lartësia e një page mujore të paditëses është në lartësi prej 482.87 euro. Andaj, i kërkoj gjykatës që të aprovoi në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të bazuar dhe ta detyroi të paditurën që paditëse të i’ a paguaj shpërblimin jubilar në shumë prej 1.448,61€, në vlerë të tri pagave mujore me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive të saj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: në emër të taksës gjyqësore për padi shumë në vlerë prej 30,00 euro, në emër të përpilimit të padisë shumë në vlerë prej 104,00 euro dhe në emër të pjesëmarrjes në një seancë gjyqësore shumë në vlerë prej 135,00 euro.

E autorizuar e të paditurës në përgjigjen në padi, në fjalën e dhënë në seancën gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se me ligjin e punës nuk është paraparë kompensimi për shpërblimin jubilar. Ka cekur se nga Qeveria e Republikës Kosovës gjegjësisht Ministria Financave nuk është paraparë vija buxhetore për këtë kategori, andaj në mungesë të linjës buxhetore gjegjësisht mjetet financiare, e paditura nuk ka mundësi objektive për ta përmbushur obligimin e kompensimit të pagave jubilar nga se kjo do të ishte në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e R. Kosovës të vitit 2021, gjithashtu kundërshtojmë dhe lartësinë e vlerës së kontestit pasi që në të është përfshirë edhe shujta, kujdestarin si shtesa në pagë, ndërsa sa i përket shtesës emergjente për Covid, e njëjta nga ana e të autorizuarit të paditësit nuk është llogaritur në vlerën e pagës së kërkuar. Lidhur pretendimet në përgjigje në padi, ka shtuar se paditësja në procedurë administrative ka realizuar shpërblimin jubilar për 20 vite të përvojës së punës. Për këto arsye, e njëjta i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit t’ia refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e

atakuar C.nr.255/21 të datës 15.04.2022 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të themeltë duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese se paditësja për herë të parë ka themeluar marrëdhënie punë tek e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), Spitali “Isa Grezda” në Gjakovë, që nga data 01.04.1989 e tutje, që vërtetohet sipas vërtetimit të lëshuar nga e njëjta. Nga lista e pagës së lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, po ashtu u vërtetua fakti se e njëjta i ka 30 vite të përvojës së punës dhe realizon pagë mujore në lartësi prej 377,00 euro. Në fund, gjykata e aprovoi pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS) dhe nenin 245 të LMD-së. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet procedurale vendimin e mori bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së. Gjukata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësit dhe atë në shumë prej 675,30 euro, pasi që erdhi në përfundim së paga mujore bazë (pa shtesa) e paditësit është saktësisht 659,00 euro, bazuar në listën e pagave të administruar në këtë shqyrtim.

Gjukata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjukatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjukatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjukata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishtme të kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe përvoja e punës së paditësit tek e paditura.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për sa i përket refuzimit të kërkesëspadisë si në dispozitivin II të aktgjykimit ta atakuar.

Me nenin 4 paragrafi 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar se “Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë vetëm anëtarët FSSHK-së”. Si dhe neni 17 pika 3, 4 dhe 5 të kësaj kontrate përcakton

se “*Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit. Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 4. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf. Andaj, gjykata e shkallë së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuara të drejtën materiale të referuara për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditëses dhe lartësinë e saj.*

Pretendimi ankimor i të paditurit se nuk kanë ndarë buxhet nga niveli qendrorë për të përmbushur detyrimet të cilat dalin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (KKS-ja), është i paqëndrueshëm për faktin se është detyrim i organeve kompetente në nivel qendror dhe lokal duke përfshirë edhe të paditurin që me kohë ti parashohin dhe përmbushin detyrimet kontraktuale të cilat dalin nga KKS-ja.

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës Kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Gjykata e Apelit, po ashtu e ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se paditësja nuk i ka shtjerr mjetet e brendshme për realizimin e të drejtave të saj në afatin e paraparë ligjor koform nenit 78 pika 1, nenit 79 dhe nenit 82 të Ligjit të Punës 03/L-212 , dhe gjeti se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të saj si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësja brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, dhe kjo asesi nuk nënkupton se paditësja nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura ashtu siç pretendon e paditura, përkundrazi, e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Gjykata e Apelit, refuzon si të pa bazuar edhe pretendimet ankimore të palëve ndwrgjyqwe në ankesë, të cilat theksojnë se gjykata gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale

duke e vërtetuar aktgjykimin e atakuar edhe në pjesën aprovuese të tij dhe atë refuzuese, për faktin se një page mujore nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga, e atë më tepër sipas listës së pagës EM00035185 të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditëses me datë 31.12.2020 konstatohet se paditësja ka pranuar si shtesë shumë prej 45.76 euro në emër të shujtës dhe 126.14 euro në emër të kujdestarisë, andaj ri kompensimi i tillë është i pa bazuar.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit për shpërblim jubilar t'ia kompensojë shumë e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushje detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitatën nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifën për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palëve ndrygjëqëse, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4261/2022, datë 18.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi